



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Nr 1336 prot

Vlorë më 27/7/2021

Vendim

Nr 8 datë 22.7.2021

PËR

**NDRYSHIM BRENDA ZERAVE TË BUXHETIT TE KËSHILLIT TË QARKUT
TË VITIT 2021 , MIRATUAR ME VKQ NR 22 DT.28.12.2020**

Këshilli i Qarkut Vlorë pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur, nga grupi i punës për ndryshim brenda buxhetit të Këshillit të Qarkut të vitit 2021, mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore “ neni 8 pika 2 neni 9 pika 1.1, b neni 31 pika 1.2.3 neni 34, neni 38, neni 40, neni 41 ,neni 72 pika 5, neni 77 pika dh, neni 83, pika ç. .
- Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore“, neni 40 .
- Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar.
- Ligjin nr. “ për buxhetin e vitit 2020“, neni 16.
- Ligjin nr. 137/2016 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Komisionit European për programin INTERREG IPA të bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri, 2014-2020.
- V.K.M. nr. 783 dt. 09.11.2016 “Për miratimin në parim të marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Komisionit European për programin INTERREG IPA të bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri, 2014-2020”
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit“.
- Udhëzimi plotësues i Ministrisë së Financave nr 4 dt.25/01/2021 datë “Për zbatimin e buxhetit“ të vitit 2021.

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshim në zera brënda buxhetit te shpenzimet për vitin 2021 në lekë, si më poshtë:

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati I Kulturës Labëria, kati i Tretë
Rruga “Fejzo Gjomema” Skelë
Vlorë

E-mail: info@qarkuvlore.gov.al

a).Të miratojë ndryshim në Emërtesën e Investimeve të parashikuar për bashkinë Delvinë në vitin 2021:

Duke u mbështetur në kërkesën e bashkisë Delvinë me shkresë nr 1119 prot dt 10/05/2021 për ndryshim emërtim Investimi, grupi i punë përgatiti materialin për ndryshim.

Fondi i prashikuar në objektin (Rikonstruksion i Fasadës së Pallatit të Kulturës dhe hidroizolimi i faracës) me vlerë 2.741.000 lekë, të kaloje për parashikim në projekt buxhetin “2022-2024”. Ky fond të kaloje për parashikim në buxhetin e vitit 2021 në emërtesën Rikonstruksion i Fasadës së Pallatit nr 14/18 dhe sistemim oborri në lagjen “9 Tetori me të njejtën vlerë, i parashikuar për tu Investuar në projekt buxhetin e vitit 2022-2024..

b) Të miratojë ndryshim në parashikimin e fondeve në zera brenda art 602; te pakësojë fonde të miratuara për dieta jashtë shtetit në vlerë prej 238.515 dhe të kalojë këte vlerë në zërin (Hartimi i 32 preventivave dhe planimetrive përkatëse) sipas akti arrëveshjes së miratuar me Istitutin e Ndërtimit ,për objektet e dëmtuara gjate vitit 2018 si rezultat i fatkeqësive natyrore, në teritotin e bashkinë Selenicë.

1.. Shpenzimet e germës B/ pika 1, gërma (d), pika 2 gërma (a) do të do të përdoren sipas pasqyrës bashkëlidhur.

2.Shpenzimet e Germës B ,për investime sipas pikës 1 gërma (f,h) ; pika 2 gërma (b,c) ; pika 3. gërma (b), pika 4 gërma a, do të përdoren në objektet e mëposhtme :

4.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori : Financ – Buxhet – Sherbime.

5. Kryetari i Këshillit të Qarkut autorizohet të bëjë transferimin e fondeve operative pa limit për artikujt e miratuar nga Këshilli i Qarkut brënda Institucionit.

6.Përgjegjësi Financ Buxhetit pranë Këshillit të Qarkut autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuar nga Këshilli i Qarkut sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financave për cdo muaj.

7. Ky vendim hyn në fuqi sipas **ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”**.

Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë nr ____prot, dt ____/____/2021